




This project is funded by
the European Union



50
YEARS

Empowered lives. Resilient nations.



INSTRUMENT PRAKTIK

PËR INTEGRIMIN E PERSPEKTIVËS GJINORE
NË KUADRIN LIGJOR DHE TË POLITIKAVE PËR
ARMËT E VOGLA DHE TË LEHTA (SALW)

SEESAC

Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) ka një mandat nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal për të mbështetur të gjithë aktorët ndërkombëtarë dhe kombëtarë me qëllim forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe rajonale për kontrollin dhe pakësimin e përhapjes dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta, duke kontribuar kështu në rritjen e stabilitetit, të sigurisë dhe të zhvillimit në Evropën Juglindore dhe Lindore.

SEESAC po zbaton VENDIMIN E KËSHILLIT të BE-së 2013/730/CFSP, në mbështetje të aktiviteteve të SEESAC-ut për çarmatimin dhe kontrollin e armëve në Evropën Juglindore. Përgatitja e këtij instrument u mbështet bujarisht nga Bashkimi Evropian përmes Vendimit të lartpërmendur të Këshillit.

Për më shumë informacion, kontaktoni:

Koordinatorin e SEESAC-ut
Bulevar Zorana Đinđića 64, 11070 Beograd / SERBIA
Telefon: +381 (11) 4155 300
Faks: +381 (11) 4155 499
Email: seesac@undp.org
www.seesac.org

© SEESAC 2016 – Të gjitha të drejtat të rezervuara

Ky instrument u përgatit nga Dragan Božanić. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të vetë autorit dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian. Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialit në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian për 1) statusin ligjor të një shteti, territori ose zone, apo për autoritetet ose grupet e armatosura të tij; ose 2) për vijëzimin e kufijve të tij.

FALËNDERIME

U jemi mirënjohës personave të mëposhtëm për kontributin dhe komentet e tyre të çmuara gjatë hartimit të këtij instrumenti:

Profesore Erica Bowen, PhD, Anëtare e Asociuar e Shoqatës Britanike të Psikologjisë (AFBPsS)
Psikologe e miratuar dhe Psikologe Mjeko-Ligjore, Profesore e lëndës së parandalimit të dhunës dhe abuzimit
Qendra Kombëtare për Studimin dhe Parandalimin e Dhunës dhe Abuzimit, Universiteti i Worcester-it

Vanja Macanović, Avokate
Qendra e Grave Autonome

Biljana Nastovska
Specialiste e çështjeve gjinore – PNUD në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë

Për përgatitjen e këtij instrumenti dhanë kontributin dhe komentet e tyre anëtarët e mëposhtëm të ekipit të SEESAC-ut: Dr. Ivan Zveržhanovski; Bojana Balon; Danijela Đurović; Juliana Buzi; Slobodan Bošković; Alain E. Lapon; Violeta Gaši dhe Francesco Buscemi.



INSTRUMENT PRAKTIK

**PËR INTEGRIMIN E PERSPEKTIVËS
GJINORE NË KUADRIN LIGJOR DHE TË
POLITIKAVE PËR ARMËT E VOGLA DHE
TË LEHTA (SALW)**

PËRMBAJTJE

HYRJE	5
Problematikat kryesore gjinore në lidhje me SALW-et në Evropën Juglindore	6
Përgjigja me masa ligjore dhe politike në Evropën Juglindore	8
INSTRUMENTUL	10
HAPI 1	
Sigurimi i konsensusit mes politikëbërësve mbi rëndësinë e çështjeve gjinore për kontrollin e SALW-ve	11
HAPI 2	
Krijimi i një pasqyre të gjendjes së grave dhe burrave në lidhje me SALW-et - Mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë	13
HAPI 3	
Identifikimi i modeleve dhe problematikave gjinore - Analiza gjinore	17
HAPI 4	
Shqyrtimi i modeleve gjinore të identifikuara - Masat ndaj tyre	21
HAPI 5	
Ndjekja e progresit - Monitorimi dhe vlerësimi	23

HYRJJE

Ky instrument është përgatitur për t'iu bashkangjitur studimit „Çështjet gjinore dhe SALW-et”: Problematikat kryesore dhe përgjigja me politika në Evropën Juglindore për të mbështetur vënien në zbatim të rekomandimeve dhe për të lehtësuar përfshirjen e perspektivës gjinore në hartimin dhe zbatimin e politikave për kontrollin e SALW-ve. Instrumenti, duke qenë i thjeshtë dhe i lehtë për t'iu përdorur, është projektuar t'iu vijë në ndihmë politikëbërësve.


PROBLEMATIKAT KRYESORE GJINORE NË LIDHJE ME **SALW**-ET¹ NË EVROPËN JUGLINDORE

Analiza e të dhënave të disponueshme të ndara sipas gjinisë dhe shqyrtimi i literaturës ekzistuese ka konfirmuar se modelet mbizotëruese gjinore luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin dhe ndikojnë te praktikrat mbizotëruese për SALW-et dhe tek efektet e përdorimit dhe keqpërdorimit të SALW-ve.

Për shembull:

- Burrat përbëjnë shumicën absolute të autorëve (më shumë se 97 për qind), si edhe të viktimave të incidenteve me armë zjarri (mbi 80 për qind).
- Gratë janë shumë rrallë autore të incidenteve të tilla (1-3 për qind të rasteve), ndërkohë që janë shumë më shpesh viktimat e tyre (nga 9 deri në 22 për qind).

FIGURA 1: **Autorët e incidenteve me armë zjarri, sipas gjinisë, 2011-2015**




Burimi: Baza e të dhënave e SEESAC (Shënim: Të dhënat për Shqipërinë janë dhënë vetëm për vitin 2015)

1 SALW nënkupton "armë të vogla dhe të lehta".

* Referencat për Kosovën kuptohen në kontekstin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999).

FIGURA 2: **Viktimat e vrasjeve me paramendim në incidentet me armë zjarri, sipas gjinisë**



- Prania e armëve të zjarrit në incidentet e dhunës në familje prek shumë herë më shumë gratë se sa burrat. Vrasjet nga partneri intim janë forma më e përhapur e vrasjeve të femrave, ndërkohë që vrasjet nga partnerja intime zënë vetëm një pjesë të vogël në numrin total të vrasjeve të meshkujve

FIGURA 3: **Përqindja e vrasjeve nga partneri intim në numrin e përgjithshëm të vrasjeve, sipas gjinisë**






FIGURA 4: **Përqindja e vrasjeve me armë zjarri nga partneri ku viktimat janë gratë (femicide) në numrin e përgjithshëm të vrasjeve nga partneri intim**



Burimi: Baza e të dhënave e SEESAC

- Sa i përket zotërimit, dominimi i meshkujve arrin në mbi 95 për qind dhe ky model gjinor i kërkesës për armë zjarri është i qëndrueshëm në kohë.
- Në të gjitha shoqëritë e Evropës Juglindore, ka një përfaqësim joproporcional të djemve autorë dhe viktima.

FIGURA 5: **Zotërimi i armëve të zjarrit, sipas gjinisë**



Burimi: VAV 2014 për Malin e Zi, Moldavinë dhe Serbinë, baza e të dhënave e SEESAC për Bosnjë-Hercegovinën dhe Shqipërinë. Për Kosovën* nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë.

- Gratë kanë tendencën për të pasur një qëndrim më negativ ndaj SALW-ve dhe shumë prej organizatave të grave vazhdimisht kanë përkrahur kontroll më të rreptë për SALW-et.
- Gratë janë ende shumë pak të përfaqësuara në procesin e hartimit të politikave dhe në institucionet përgjegjëse për kontrollin e SALW-ve.

Përgjigja me masa ligjore dhe politike në Evropën Juglindore

- Pavarësisht dimensioneve thellësisht gjinore të SALW-ve, politikat që rregullojnë SALW-et në Evropën Juglindore nuk i adresojnë çështjet gjinore në një mënyrë të atillë që të përputhet me shkallën e problemit. Përpjekjet për të adresuar problematikat ekzistuese gjinore në legjislacion ndërmerren vetëm në mënyrë sporadike dhe të copëzuara, kryesisht në fushën e dhunës në familje nëpërmjet rregullimit të armëmbajtjes nga personat civilë.
- Legjislacioni për armët e zjarrit në Evropën Juglindore ka shënuar progres të rëndësishëm në drejtim të miratimit të një sërë dispozitave ligjore që rregullojnë armëmbajtjen nga personat civilë, duke e lidhur atë me dhunën në familje. Dispozita të tilla, që kufizojnë aksesin tek armët e zjarrit ose heqin të drejtën për mbajtjen e tyre nëse ka raste të dhunës në familje, janë

* Referencat për Kosovën kuptohen në kontekstin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999).

miratuar thuajse në të gjithë rajonin, duke u bërë pjesë e ligjeve për armët e zjarrit. Një grup tjetër ligjesh, të tilla si ligjet kundër dhunës në familje, ligjet për kodin e procedurës penale dhe ligjet për policimin, ndihmojnë në rregullimin e kësaj çështjeje, edhe pse ata nuk janë domosdoshmërisht gjithnjë koherentë.

- Pavarësisht nga ndryshimet e fundit ligjore, përqaqindja e lartë e grave të vrara me armë zjarri në kontekstin familjar në Evropën Juglindore mbetet e pandryshueshme. Shifra të tilla bëjnë thirrje për një vlerësim të plotë të zbatimit të kuadrit ligjor që rregullon armëmbajtjen nga personat civilë dhe për identifikimin e mangësive në legjislacion, që do të shërbejnë më pas edhe si pikënisje për reformat e ardhshme ligjore.
- Studimet e fundit mbi efikasitetin e masave institucionale kundër dhunës në familje theksojnë fuqinë e normave gjinore dhe pabarazitë, të cilat nxisin stereotipat dhe ndikojnë në zbatimin e ligjit në praktikë.
- Sa i përket masave ligjore për keqpërdorimin e armëve të zjarrit që mbahen në mënyrë të jashtëligjshme në kontekstin e dhunës në familje, përveç masave ekzistuese (si legalizimi), duhet të hartohen zgjidhje të reja dhe inovative për ta trajtuar këtë çështje në mënyrë më efektive.
- Sa i përket kuadrit të politikave (strategjitë për kontrollin e SALW-ve dhe planet shoqëruese të veprimit), tendenca mbizotëruese është se problematikat kryesore të politikave gjinore nuk po pranohen si çështje të rëndësishme të politikave që kanë nevojë të trajtohen në mënyrë adekuate. Si rrjedhojë, çështjet gjinore po lihen shumë mënjane në axhendën e politikave të SALW-ve.
- Vetëm në raste të veçanta ka një angazhim formal për barazinë gjinore dhe integrimin gjinor. Megjithatë, edhe në këto raste, kjo nuk bëhet në mënyrë sistematike. Mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë ose e kërkimeve gjithëpërfshirëse për lidhjet ndërmjet çështjeve gjinore dhe SALW-ve vazhdimisht përbën një faktor pengues për hartimin e politikave për SALW-et që u përgjigjen çështjeve gjinore dhe kontribuon në njohjen e pamjaftueshme e problemit.
- Mungesa e analizës gjinore në procesin e hartimit të politikave i bën problematikat gjinore që lidhen me SALW-et edhe më të padukshme dhe, për pasojë, ato nuk janë aspak, ose vetëm pak, pjesë e ndërhyrjes me politika.
- Njohja e ulët e dallimeve gjinore në lidhje me zotërimin, përdorimin dhe keqpërdorimin e armëve të zjarrit, efektet e diferencuara të armëve të zjarrit mbi gratë dhe burrat, është në kontrast të thellë me efektet shumë të forta gjinore të SALW-ve.
- Rezultati përfundimtar i kësaj qasjeje është që kuadri ligjor dhe strategjik për SALW-et nuk merr në konsideratë nevojat për siguri të ndara sipas gjinisë dhe shqetësimet e burrave dhe grave, duke sjellë në këtë mënyrë reduktimin e kompleksitetit të problematikës së politikave. Duke vepruar kështu, supozohet se nevojat e sigurisë janë njësoj për të gjithë qytetarët dhe se ato mund të trajtohen në mënyrë të njëjtë, pavarësisht gjinisë, moshës, racës etj. Si rezultat, ai pasqyron edhe supozimin se zbatimi i masave dhe ndërhyrjeve të planifikuara do të sjellë rritje të sigurisë për të gjithë qytetarët.

INSTRUMENTI

Bazuar në gjetjet e përmendura më lart, SEESAC ka zhvilluar një instrument praktik me qëllim lehtësimin e integritit të perspektivës gjinore tek kuadrot ligjorë dhe të politikave për SALW-et dhe për të ndihmuar në kapërcimin e sfidave të identifikuara.

Ky instrument është menduar kryesisht për anëtarët e Komisioneve të SALW-ve, që janë përgjegjës për zhvillimin e masave të kontrollit për armët e vogla dhe të lehta, duke përfshirë këtu edhe strategjitë dhe planet e veprimit për SALW-et. Komisionet e SALW-ve janë përgjegjës edhe për identifikimin, ndjekjen dhe vlerësimin e ndikimit të SALW-ve në shoqëri, në sigurinë dhe mbrojtjen e njerëzve dhe në zhvillimin ekonomik dhe social, që duhet të shërbejnë edhe si baza për hartimin e politikave. Së fundmi, Komisionet e SALW-ve janë përgjegjëse edhe për monitorimin dhe vlerësimin e përpjekjeve të ndërmarra.

Qëllimi i këtij instrumenti është që të ndihmojë hartuesit e politikave për të identifikuar dhe trajtuar më mirë rreziqet specifike gjinore nga SALW-et dhe, në këtë mënyrë, të reduktojë efektet negative të përhapjes së SALW-ve te gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, duke nxitur kështu zhvillimin e politikave të reja. Kjo do të rrisë efikasitetin e kuadrove ligjorë dhe të politikave për SALW-et, duke sjellë përmirësime të prekshme në sigurinë e të gjithë qytetarëve, grave, burrave, vajzave dhe djemve.

Instrumenti i sugjeruar përfiton nga një kombinim i gjerë i metodologjive dhe qasjeve dhe bazohet në disa nga praktikët e provuara më së miri për integrimin e perspektivës gjinore në politikat publike (JämStöd, 2007). Ai gjithashtu mbështetet në një mori instrumentesh të tjerë, si listat e kontrollit, udhërrëfyesit për mbledhjen e të dhënave dhe metodologjitë për analizat gjinore, siç është „Metoda 4R“ (Po aty, f. 47, UNDP, 2008). Shumë i rëndësishëm është fakti se instrumenti ka në themel përvojën e punës me Komisionet e SALW-ve të Evropës Juglindore dhe njohuritë për sfidat me të cilat ata përballen gjatë hartimit të politikave të bazuara në të dhëna.

Nëse duam që të jetë një ndërmarrje e qëndrueshme, integrimi i perspektivës gjinore duhet të trajtohet në mënyrë strategjike dhe me një qasje afatgjatë. Perspektiva gjinore duhet të jetë pjesë thelbësore dhe e rregullt e planifikimit dhe hartimit të politikave, të orientojë zbatimin e tyre të përditshëm, por edhe të monitorohet në mënyrë efektive dhe të vlerësohen efektet dhe përfitimet për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë. Gjetjet e vlerësimit do nxisin, më pas, një cikël të ri politikash, duke hapur kështu rrugën për politika më të mira dhe më efektive.

Ndërmarrja e hapave të mëposhtëm konkretë do të lehtësojë shndërrimin e angazhimeve për barazi gjinore në masa praktike:

HAPI 1:

SIGURIMI I KONSENSUSIT MES POLITIKËBËRËSVE MBI RËNDËSINË E ÇËSHTJEVE GJINORE PËR KONTROLLIN E **SALW**-VE

Kjo është edhe pika e nisjes për punën mbi barazinë gjinore. Në mënyrë që të sigurohet integrimi efikas dhe i qëndrueshëm i çështjeve gjinore në kontrollin e SALW-ve, është e nevojshme vendosja e disa parakushteve të caktuara.

1. Të kuptuarit reciprok – Trajnim mbi çështjet gjinore

Të kuptuarit reciprok për rolin që çështjet gjinore luajnë në formimin e sjelljes lidhur me SALW-et, për praktikën dhe për rreziqet specifike për gratë dhe burrat është parakusht themelor për integrimin efikas dhe të qëndrueshëm të perspektivës gjinore në kuadrot për kontrollin e SALW-ve. Prandaj është e nevojshme që të garantohet se të gjithë aktorët e përfshirë të ndajnë këtë njohuri dhe të jenë trajnuar mbi barazinë gjinore, integrimin gjinor, analizat gjinore, dhunën në familje, ligjet dhe strategjitë për barazinë gjinore, dhe lidhjet mes çështjeve gjinore dhe SALW-ve.

2. Rëndësia e barazisë gjinore në punën për kontrollin e SALW-ve

Integrimi i perspektivës gjinore në kontrollin e SALW-ve nuk nënkupton thjesht numërimin e grave dhe të burrave, të vajzave dhe djemve, por përdorimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë për të njohur dhe t'iu përgjigjur rreziqeve specifike gjinore që SALW-et u sjellin grave dhe burrave. Integrimi i perspektivës gjinore në të gjithë ciklet e kontrollit dhe menaxhimit të SALW-ve rrit të kuptuarit e kompleksitetit të problemit dhe, për këtë arsye, mundëson krijimin e politikave më të sakta dhe efektive për kontrollin e SALW-ve, të cilat janë edhe më të përshtatshme për përballimin e sfidave.

3. Grupet e interesit dhe pjesëmarrja

Përfshirja e institucioneve të barazisë gjinore, organizatave të grave dhe e ekspertëve gjinorë do të lehtësojë integrimin e perspektivës gjinore dhe do të garantojë që projekti të jetë i besueshëm. Përfshirja do të sjellë në tryezë perspektiva të ndryshme dhe do të zgjerojë gamën e temave të trajtuara nga politikat, si edhe do të sigurojë që politikat të jenë të informuara nga ekspertiza.

4. Angazhimi zyrtar

Duhet të ekzistojë një angazhim zyrtar për barazinë gjinore në punën për SALW-et. Kjo mund të arrihet duke përfshirë një deklaratë se si perspektiva gjinore do të trajtohet në dokumentin strategjik dhe planin e veprimit.

ÇFARË DUHET BËRË:

- Organizimi i trajnimeve për barazinë gjinore, aspektet gjinore të SALW-ve, analizat gjinore, integrimin gjinor (shih trajnimin e SEESAC), dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe në marrëdhënie;
- Njohja e aktorëve me ligjet dhe politikat e barazisë gjinore, si edhe me standardet dhe angazhimet ndërkombëtare;
- Shkëmbimi i përvojës me homologët e vendeve dhe territoreve të tjera, që kanë nisur tashmë punën në këtë fushë;
- Identifikimi i nevojave për ta çuar më tej punën: çfarë lloj mbështetjeje është e nevojshme për të integruar në mënyrë më efektive perspektivën gjinore / për të pasur një pasqyrë të qartë mbi rëndësinë e çështjeve gjinore për punën përkatëse / për të kërkuar ekspertizë;
- Përfshirja e përfaqësuesve të mekanizmave të barazisë gjinore, OJQ-ve të grave dhe specialistëve për çështjet gjinore në zhvillimin e politikave;
- Sigurimi i përfaqësimit të balancuar të grave dhe burrave në procesin e hartimit të politikave. Përcaktimi i kësaj nëpër rregullore.

HAPI 2:

KRIJIMI I NJË PASQYRE TË GJENDJES SË GRAVE DHE BURRAVE NË LIDHJE ME **SALW**-ET – Mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë.


Të dhënat e ndara sipas gjinisë janë një parakusht për të kuptuar lidhjet midis çështjeve gjinore dhe SALW-ve, si edhe janë baza për hartimin e politikave gjinore të përgjegjshme të bazuara në të dhëna. Nëse të dhënat gjinore nuk janë të disponueshme, problematikat gjinore do të jenë të padukshme dhe do të pengohet kuptimi i plotë i problemit. Pa informacion, rreziqet specifike që gratë dhe burrat ndeshin në lidhje me SALW-et dhe dallimet në nevojat e tyre të sigurisë, të cilat duhet të trajtohen, mund të neglizhohen. Mungesa e të dhënave pengon zhvillimin e politikave të përgjegjshme gjinore dhe do të ndikojë negativisht në karakterin e bazuar në të dhëna të reagimit me politika. Mbledhja e rregullt e të dhënave është thelbësore sepse tendencat bëhen të dukshme vetëm me kalimin e kohës nga një perspektivë afatgjatë.

Cilat të dhëna duhen mbledhur?

Problematikat kryesore të politikave, të përshkruara në hyrje, mund të shërbejnë si një pikënisje kur të vendoset se cilat të dhëna të ndara sipas gjinisë duhen mbledhur. Të dhënat do të ndihmojnë për të identifikuar shkallën e problemit dhe cilat problematika janë më të rëndësishme për kontekstin e dhënë. Pasqyra e fituar nga ky informacion duhet të nxisë nisjen e diskutimeve (shih hapin 3), të cilat do të orientojnë edhe më mirë mbledhjen e të dhënave.

Identifikimi se cilat të dhëna janë të ndara sipas gjinisë dhe cilat të dhëna, që janë pjesë e të dhënave të zakonshme, mund të ndahen, duhet të jetë një pikënisje për mbledhjen e të dhënave. Për shembull, të gjitha të dhënat mbi viktimat dhe autorët e incidenteve me armë zjarri, zotëruesit e armëve të zjarrit, personat e pajisur me leje për të blerë/mbajtur armë zjarri dhe të dhëna të tjera përkatëse duhet që të ndahen në vazhdimësi sipas gjinisë.

SHEMBULLI 1: **Lista e të dhënave për t'u mbledhur mund të përmbajë informacionet e mëposhtme:**

	2015		2014		2013		2012		2011	
										
Autorët e incidenteve me armë zjarri ¹										
Viktimat e vrasjeve me paramendim										
Viktimat e vrasjeve me paramendim në incidentet me armë zjarri										
Zotëruesit e armëve të zjarrit										
Numri i lejeve të lëshuara për të blerë armë zjarri										
Numri i personave të vvarë nga partneri intim ²										
Numri i personave të vvarë nga partneri intim me armë zjarri										
Numri i personave të vvarë nga partneri intim me armë zjarri me leje										
Numri i personave të vvarë nga partneri intim me armë zjarri pa leje										
Numri i personave të cilët dorëzuan SALW-e gjatë fushatave të grumbullimit										



.....



- 1 Incidenti përfshin këto: vrasje, vrasje të rëndë, përpjekje vrasjeje, vetëvrasje, përpjekje vetëvrasjeje, të shtënat në vend publik, mbajtja e palejuar e armëve dhe mjeteve shpërthyes, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, dhuna në familje.
- 2 Partneri intim ka të bëjë me: bashkëshortin/bashkëshorten, ish bashkëshortin/ish bashkëshorten, partnerin jashtë martesë/partneren, ish partnerin jashtë martesë/partneren, të dashurin/të dashurën, ish të dashurin/të dashurën.

Në mënyrë që të kuptohen plotësisht aspektet gjinore të SALW-ve, është gjithashtu e nevojshme të kuptohet se si gjinia ndërthuret me karakteristika të tjera demografike, siç janë moshë, raca, përkatësia etnike, aftësia e kufizuar, vendi i banimit (qytet/fshat).

Tabela e mëposhtme tregon një shembull të të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe moshës.

SHEMBULLI 2: Të dhënat për gjininë dhe moshën

Autorët e incidenteve me armë zjarri, sipas gjinisë dhe moshës		
15-29		
30-44		
45-60		
60+		

Viktimat e incidenteve me armë zjarri, sipas gjinisë dhe moshës		
15-29		
30-44		
45-60		
60+		

Në raste të caktuara, mund të përdoren edhe të dhëna të cilat nuk i referohen direkt grave dhe burrave, por që janë të lidhura me problemet specifike gjinore, siç janë dhuna ndaj grave, dhuna nga partneri intim dhe dhuna në familje. Për shembull, të dhëna të tilla mund të përfshijnë informacione mbi masat ligjore ndaj dhunës në familje, si numri i aplikimeve të refuzuara për arsye të dhunës në familje, siç edhe tregohet në shembullin 3.

SHEMBULLI 3: Numri i aplikimeve të refuzuara për arsye të dhunës në familje

	2015	2014	2013	2012	2011
Numri i aplikimeve të refuzuara për të blerë armë zjarri					
Numri i aplikimeve të refuzuara për arsye të dhunës në familje					

Në shumicën e planeve të veprimit për zbatimin e strategjive për SALW-et parashikohen edhe studime për ndikimin SALW-ve në shoqëri. Kjo është një mundësi e vlefshme për të plotësuar hendekun në mbledhjen e të dhënave dhe një pikë nisjeje për integrimin e perspektivës gjinore. Prandaj, të gjitha të dhënat duhet të jenë të ndara sipas gjinisë.

Gjatë mbledhjes së të dhënave, është e rëndësishme që të identifkohen jo vetëm të dhënat në dispozicion, por edhe ato që mungojnë, të përcaktohen arsyet se pse ato mungojnë dhe se si duhet trajtuar kjo mangësi. Kjo duhet diskutuar gjatë takimit të Komisionit të SALW-ve me anëtarët e tjerë të Komisioneve të SALW-ve dhe me aktorët e tjerë të përfshirë në këtë proces.

Ndonjëherë, të dhënat e rëndësishme nuk janë pjesë e praktikave të rregullta të mbledhjes së të dhënave. Për këtë arsye, po aq i rëndësishëm është edhe shfrytëzimi i të dhënave nga burime të tjera, si ato të prodhuara nga UNODC, UNDP, OSH, Vrojtimi për armët e vogla, DCAF, institucionet e statistikave, baza e të dhënave e SEESAC etj .

ÇFARË DUHET BËRË:

- Identifikimi i të dhënave gjinore që duhen mbledhur;
- Përcaktimi i burimeve të informacionit dhe sigurimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë për viktimat dhe autorët e incidenteve me armë zjarri, zotëruesit e armëve, etj. Përdorimi i burimeve të tjera të të dhënave, të ndara sipas gjinisë (bazat e të dhënave dhe raportet e prodhuara nga institucionet qeveritare, organizatat ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile etj.);
- Identifikimi i hendeqeve në të dhënat e disponueshme, shqyrtimi i sfidave të ndeshura dhe hartimi i planit për kapërcimin e tyre;
- Organizimi i trajnimeve gjinore për të ngarkuarit me mbledhjen e të dhënave.

HAPI 3:

IDENTIFIKIMI I MODELEVE DHE PROBLEMATIKAVE GJINORE – ANALIZA GJINORE

Përfshirja e të dhënave të mbledhura në analizën e situatës, duke u siguruar për marrjen e tyre në konsideratë gjatë nxjerrjes së konkluzioneve. Eksplorimi i dallimeve gjinore në lidhje me çështjet e kontrollit të SALW-ve dhe identifikimi dhe përcaktimi i sfidave dhe rreziqeve të veçanta të lidhura me gjininë.

Një paketë e gjerë me metoda praktike, të tilla si udhëzues, lista kontrolli dhe udhëzime për analizën gjinore, është zhvilluar dhe mund të gjendet lehtësisht². Një parakusht për një analizë të mirëfilltë të barazisë gjinore është edhe njohja e plotë e regjimeve gjinore dhe e marrëdhënieve gjinore mes grave dhe burrave. Edhe një herë, pjesëmarrja e ekspertëve gjinorë, organizatave të grave dhe e mekanizmave të barazisë gjinore do të lehtësojë procesin dhe do të ndihmojë në qasjen e duhur ndaj sfidave dhe në ofrimin e zgjidhjeve të përshtatura për sfidat në fjalë, duke siguruar që burimet e kufizuara të shfrytëzohen në mënyrën më të mirë të mundshme.

Kjo fazë përbëhet nga dy hapa të ndërlidhura në mënyrë reciproke. Hapi i parë, bazuar në të dhënat e ndara sipas gjinisë, përfshijet të identifikojë modelet gjinore mbizotëruese dhe t'i përgjigjet pyetjes:

a. Çfarë lloj modelesh gjinore konstatojmë?

Nëse mblidhen të dhëna të ndara sipas gjinisë, është e mundur të identifikohen modelet gjinore mbizotëruese. Modelet gjinore duhet të formulohen në mënyrë të drejtpërdrejtë.

2 UNDP. 2007. Gender Mainstreaming in Practice: A Toolkit. Bratislava: UNDP Regional Bureau for Europe and the Commonwealth of Independent States; JämStöd. 2007. *Gender Mainstreaming Manual. A Book of Practical Methods from the Swedish Gender Mainstreaming Support Committee*. Stockholm: Swedish Government Official Reports; UNDP. 2001. Gender in Development Programme. Learning and Information Pack: Gender Analysis. New York: UNDP Learning Resources Centre;

Për shembull:

Burrat përbëjnë shumicën absolute të autorëve të incidenteve me armë zjarri.

Burrat përbëjnë shumicën e viktimave të incidenteve me armë zjarri.

Zotëruesit e armëve të zjarrit janë thuajse tërësisht burra.

Gratë janë pothuajse asnjëherë autore të incidenteve me armë zjarri.

Ka më shumë gra viktime sesa gra autore të incidenteve me armë zjarri.

Gratë janë më të rrezikuara se sa burrat prej vrasjeve me armë zjarri në shtëpi nga partnerët intimë.

Meshkujt e rinj përbëjnë shumicën e autorëve dhe viktimave të dhunës me armë.

Lejet për armë zjarri nuk refuzohen pothuajse asnjëherë për shkak të dhunës në familje.

Gratë janë më pak të përfaqësuara në komisionet e SALW-ve.

Pas këtij hapi, është e qartë se ka problematika të shumta që lidhen me aspektet gjinore të kontrollit të SALW-ve, të cilat duhet të trajtohen në mënyrë të përshtatshme.

b. Pse i kemi këto modele gjinore?

Hapi i dytë është një reflektim mbi modelet e identifikuar, diskutimi i tyre dhe përpjekjet për të përcaktuar shkaqet e tyre. Me pak fjalë, shtrohet pyetja se pse ndodh kështu? Në këtë fazë mund të dalë në pah nevoja për hulumtime shtesë.

SHEMBULLI 1: **Modeli gjinor: Lejet për armë zjarri nuk refuzohen pothuajse asnjëherë për shkak të dhunës në familje.**

Pse ndodh kështu?

Si lidhet kjo me prevalencën e lartë të dhunës në familje? A e ndalon ligji pajisjen me leje nëse personi identifikohet si autor i veprës penale të dhunës në familje? A kontrollohet si duhet e kaluara e personit? A i janë nënshtruar punonjësit e policisë trajnimit të nevojshëm? A është bërë shqyrtimi i vdekjeve nga dhuna në familje? Cili ishte statusi i armëve të zjarrit?

Të dhënat e mbledhura nga SEESAC, në bashkëpunim edhe me Komisionet e SALW-ve në Evropën Juglindore, tregojnë se dhuna në familje rrallë përdoret si arsye për kushtëzimin e lejes për mbajtje të armëve të zjarrit. Për shembull, në Bosnjë-Hercegovinë, gjatë periudhës 2011-2015, vetëm 3,3 për qind e numrit të përgjithshëm të arsyeve për refuzimin e lejes lidhej me dhunën në familje. Në Mal të Zi, gjatë së njëjtës periudhë, nuk ka pasur raste në të cilat leja është refuzuar për shkak të dhunës në familje. Fakti që dhuna në familje përbën vetëm një pakicë të vogël të arsyeve për refuzimin e lejes së armës së zjarrit mund të jetë tregues i nevojës për hulumtime të mëtejshme dhe për rishikimin e legjislacionit dhe praktikave ekzistuese. Në

të njëjtën kohë, është urgjente që të sigurohet informacion më i plotë për strukturën e përgjithshme të arsyeve më të shpeshta të refuzimit të lejeve të armëve të zjarrit.

Përfshirja e ekspertizës gjinore do të jetë e një rëndësie vendimtare për të identifikuar arsyet themelore që do të trajtohen nga politikat dhe do të garantojë që zgjidhja përputhet me problemin, që burimet e kufizuara do të shfrytëzohen në mënyrën më të mirë të mundshme dhe që efikasiteti i punës për kontrollin e SALW-ve do të rritet.

SHEMBULLI 2: Modeli gjinor: Meshkujt e rinj përbëjnë shumicën e autorëve dhe viktimave të dhunës me armë.

Pse ndodh kështu?

Në këtë fazë është e rëndësishme të shtrohen disa pyetje. A ka ndonjë të dhënë tjetër shtesë për të rinjtë meshkuj që kanë kryer akte dhune me armë zjarri? Përmes çfarë lloji dhune u krye incidenti (krim, krim i organizuar, bandat e të rinjve, dhunë në shkollë, dhunë në familje, dhunë nga partneri intim etj.)? A ka të dhëna për gjendjen e tyre sociale dhe ekonomike? A ekziston ndonjë kushtëzim kulturor (kultura e armëve), i cili ndikon që të rinjtë të përdorin armët e zjarrit? Ku janë faktet e një kulture të tillë? A është bërë ndonjë punë parandaluese?

Studimet tregojnë se dhuna që përfshin armët e vogla shihet shpesh nga të rinjtë si një mjet për arritjen e statusit social dhe ekonomik që ata besojnë se e meritojnë. Prandaj armët e vogla mund të përbëjnë edhe një tërheqje të veçantë për të rinjtë, pasi ata shpesh i konsiderojnë armët si shenjë krenarie individuale, burërie dhe të statusit të zgjeruar shoqëror, që mund të jetë edhe një „simbol i fuqishëm pushteti për të rinjtë meshkuj të marginalizuar“ (Bevan dhe Florquin, 2006).

Të dhënat e pakta gjithashtu tregojnë se, në kontekste të caktuara, armët e zjarrit mund të luajnë rol në kalimin në moshën e pjekurisë. Për shembull, hulumtimi i kryer në Beograd nga OJQ-ja „Balkan Youth Union“ tregoi se ka një pabarazi të theksuar ndërmjet vajzave dhe djemve lidhur me përvojat me armë zjarri: 29 për qind e djemve dhe 48 për qind e vajzave pohuan se nuk kishin mbajtur kurrë një armë zjarri në dorë (SACISCG, 2005). Në disa zona të caktuara, si në veri të Shqipërisë dhe në Mal të Zi, armët e zjarrit kanë qenë gjithashtu pjesë e riteve të kalimit në moshën e pjekurisë, ndonëse të dhënat janë të pakta. Një studim mbi kulturën e armëve në Evropën Juglindore gjithashtu sjell edhe dëshmi të dëgjueshme për rolin e armëve të vogla për shkelësit e rinj në moshë, sidomos në drejtim të pushtetit, pasi ata e shohin armën si mjet për të „mbrojtur statusin e

tyre si njerëz që duhet t'ia kenë frikën dhe që nuk duhen kundërshtuar” (SEESAC, 2007). Roli i mediave në përkrahjen e sjelljeve të rrezikshme duhet gjithashtu të merret parasysh në këtë drejtim, si edhe faktorë të tjerë që ndihmojnë për të riprodhuar regjimet gjinore dominuese. Sa i përket masave politike përkundrejt problemit, kohët e fundit janë botuar raporte të cilat mundësojnë ndjekjen e praktikave të reja në lidhje me rezultatet e programeve të veçanta në reduktimin e dhunës me armë zjarri mes të rinjve meshkuj (Abt dhe Winship, 2016).

ÇFARË DUHET BËRË:

- Në bazë të të dhënave të mbledhura, të kryhet identifikimi i modeleve gjinore dhe formulimi i vërejtjeve;
- Nisja e diskutimit në lidhje me këto modele, gjatë takimeve të Komisionit të SALW-ve;
- Garantimi i konsultimit me ekspertët e çështjeve gjinore. Pjesëmarrja e tyre është vendimtare për identifikimin e problemeve;
- Konsultimi me analizat dhe raportet ekzistuese.

HAPI 4:

SHQYRTIMI I MODELEVE GJINORE TË IDENTIFIKUARA – MASAT NDAJ TYRE.

Në këtë hap është i nevojshëm hartimi i reagimit me politika ndaj sfidave gjinore të identifikuara:

- Vendosja e objektivave dhe qëllimeve të lidhura me gjininë;
- Zhvillimi i masave praktike dhe inovative, të bazuara në të dhëna të ndara sipas gjinisë, për të adresuar aspektet gjinore të SALW-ve;
- Zhvillimi i aktiviteteve për të përmbushur nevojat e sigurisë së grave dhe burrave dhe për të trajtuar rreziqet me të cilat përballen.

Pyetje të rëndësishme: Çfarë mund të bëjnë Komisionet e SALW-ve për të trajtuar këto çështje në kuadër të mandatit të tyre? Çfarë mund të bëhet me anë të strategjive dhe legjislacionit për SALW-et, në përputhje me gjetjet nga hapi i mëparshëm? Cila është marrëdhënia e punës së Komisioneve të SALW-ve me modelet e identifikuara? Përdorni këto pyetje për të hartuar propozimet për veprim.

SHEMBULLI 1: *Lejet për armë zjarri nuk refuzohen pothuajse asnjëherë për shkak të dhunës në familje.*

Çfarë mund të bëhet?

Politikat e ndërhyrjes

Përcaktimi në strategjinë e rishikuar i objektivave që lidhen me uljen e vrasjeve si pasojë e dhunës në familje dhe vrasjeve të grave nga partnerët e tyre intimë të kryera me armë zjarri

Aktivitetet:

- Zhvillimi i analizës së vrasjeve si pasojë e dhunës në familje dhe vrasjeve nga partnerët intimë, identifikimi i tendencave në përdorimin e armëve të zjarrit dhe identifikimi i mungesës së masave institucionale;
- Zhvillimi i rekomandimeve për ndryshime ligjore dhe të politikave;
- Organizimi i trajnimeve mbi dhunën në familje për punonjësit e policisë që lëshojnë lejet;
- Projektimi i fushatave sensibilizuese për rrezikun e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e familjes.

Iniciativat ligjore:

- Rishikimi i procesit të autorizimit dhe dhënies së lejeve në lidhje me dhunën në familje,
- Identifikimi i propozimeve për ndryshimin e akteve nënligjore ose rregulloreve dhe përcaktimi në mënyrë shumë më rigoroze i procedurave të lejeve në lidhje me dhunën në familje, duke përfshirë edhe raportimet nga bashkëshortët,
- Zhvillimi dhe miratimi i procedurave për kontrolle më të rrepta të së kaluarës,
- Trajnimi i punonjësve të policisë që do të kryejnë verifikimet lidhur me dhunën në familje,
- Përcaktimi dhe miratimi i procedurave për të kufizuar aksesin tek armët e zjarrit të personave kundër të cilëve është lëshuar urdhër mbrojtjeje.

SHEMBULLI 2 ***Të rinjtë meshkuj përbëjnë shumicën e autorëve dhe viktimave të incidenteve me armë zjarri.***

Çfarë mund të bëjmë?**Politikat e ndërhyrjes**

Objektivat që lidhen me reduktimin e të rinjve meshkuj të përfshirë në incidentet me armë zjarri

- Kryerja e një studimi mbi incidentet me armë zjarri, ku janë përfshirë të rinj meshkuj, dhe identifikimi i faktorëve specifikë të rrezikut;
- Përpilimi i programeve model që synojnë reduktimin e dhunës me armë zjarri mes të rinjve meshkuj;
- Kryerja e një analizë të perceptimit në media të armëve të zjarrit dhe ndikimit tek të rinjtë meshkuj;
- Projektimi dhe zbatimi i një fushate për rreziqet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit, duke u fokusuar tek të rinjtë meshkuj;
- Zhvillimi i një propozimi për politikat që duhen për trajtimin e kësaj çështjeje;
- Programe parandaluese pilot për të rinjtë meshkuj.

Iniciativat ligjore:

- Rritja e moshës minimale për marrjen e lejes për armë zjarri

ÇFARË DUHET BËRË:

- Nisja e diskutimit në lidhje me këto modele, gjatë takimeve të Komisionit të SALW-ve;
- Garantimi i konsultimit me ekspertët e çështjeve gjinore, pasi pjesëmarrja e tyre është vendimtare për identifikimin e problemeve;
- Konsultimi me analizat dhe raportet ekzistuese;
- Përcaktimi i aktiviteteve dhe integrimi i tyre në planin e veprimit;
- Sigurimi i buxhetit për zbatim.

HAPI 5:

NDJEKJA E PROGRESIT – MONITORIMI DHE VLERËSIMI.

Qëllimi i politikave për kontrollin e SALW-ve është rritja e sigurisë së përgjithshme të qytetarëve përmes planifikimit dhe zbatimit të masave të ndryshme për të frenuar përhapjen dhe keqpërdorimin e SALW-ve. Monitorimi dhe vlerësimi duhet të sigurojnë provën e qartë se rreziqet specifike gjinore të grave, burrave, vajzave dhe djemve janë trajtuar dhe se ata përfitojnë në mënyrë të barabartë nga masat e marra. Monitorimi i planit duhet të mbulojë plotësisht edhe zbatimin e masave të përcaktuara për të trajtuar problematikat e identifikuara gjinore.

Ka disa pika të rëndësishme për monitorimin dhe vlerësimin në përgjigje të çështjeve gjinore:

1. Garantimi se të gjithë treguesit që i referohen individëve ndahen sipas gjinisë.

Për shembull, në vend të:

Numrit të pjesëmarrësve në trajnimin për standardet ndërkombëtare të armëve të vogla,

Treguesi duhet të jetë:

Numri i pjesëmarrësve meshkuj dhe femra në trajnimin për standardet ndërkombëtare të armëve të vogla.

Kjo lejon gjurmimin e masës se deri ku është përmbushur angazhimi për të siguruar pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave. Nëse treguesit dëshmojnë se një gjë e tillë nuk ka ndodhur, atëherë mund të organizohen aktivitete të tjera, në qendër të të cilave do të ishin shumë më tepër gra, ose edhe mund të studiohen faktorët që penguan pjesëmarrjen e grave.

Monitorimi mundëson zbatimin më të mirë të aktiviteteve.

2. Garantimi i ndjekjes së zbatimit të aktiviteteve të veçanta që lidhen me gjininë të planifikuara në hapin e mëparshëm.

Për shembull, nëse aktiviteti i planifikuar është:

Zhvillimi dhe miratimi i procedurave për kontrolle më të rrepta të së kaluarës,

Treguesi do të ishte:

Miratimi i procedurave për kontrolle më të rrepta të së kaluarës duke përfshirë dhunën në familje

Ose

Nëse aktiviteti është: Fushata për rreziqet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit, duke u fokusuar tek të rinjtë meshkuj,

Treguesi do të ishte: Zbatimi i fushatës për rreziqet e keqpërdorimit të armëve të zjarrit, duke u fokusuar tek të rinjtë meshkuj.

Siç u theksua më lart, në shumicën e planeve të veprimit jepen vetëm treguesit e rezultateve. Ato janë të rëndësishëm pasi vërtetojnë se aktivitetet janë duke u zbatuar. Në rastin e aktiviteteve specifike gjinore, ato tregojnë se angazhimet janë përmbushur.

3. Garantimi i pranisë së treguesve të rezultateve që i përgjigjen problematikave gjinore

Nga vlerësimi i perspektivës, është thelbësore të identifikosh nëse qëllimi, që është rritja e sigurisë për të gjithë qytetarët, për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, është duke u arritur. Matja mbetet një detyrë shumë komplekse dhe kërkon një sërë treguesish, të cilët duhet të jetë të ndarë sipas gjinisë për të konfirmuar se nevojat e grave dhe burrave janë trajtuar dhe për të siguruar rekomandime të qarta për veprimet e mëtejshme. Vlen të theksohet përsëri se prania e ekspertizës gjinore gjatë vlerësimit do të lehtësojë identifikimin e këtyre efekteve.

Treguesit që u përgjigjen problematikave gjinore për të matur nëse siguria është rritur për gratë dhe burrat duhet të përfshijnë:

Numrin e grave dhe burrave viktime të incidenteve me armë zjarri,

Numrin e grave dhe burrave viktime të dhunës së kryer me armë zjarri nga partneri intim,

Numrin e incidenteve me armë zjarri të kryera nga të rinjtë meshkuj.

Gjetjet e monitorimit dhe vlerësimit duhet të ofrojnë rekomandime të qarta se si mund të rritet masa e përgjegjshmërinë gjinore e aktiviteteve për kontrollin e SALW-ve. Ato duhet të vënë në dukje si atë që është bërë mirë, ashtu edhe atë që duhet të përmirësohet. Së fundmi, përfundimet e vlerësimit duhet të diskutohen edhe me aktorët e tjerë, në mënyrë që të sigurohen kontributet për ciklin e ri të politikave.

ÇFARË DUHET BËRË:

- Përfshirja e palëve të interesuara që kanë ekspertizë gjinore në planifikimin e monitorimit dhe vlerësimit,
- Krijimi i treguesve të ndarë sipas gjinisë dhe caktimi i treguesve të veçantë për të ndjekur zbatimin e aktiviteteve specifike gjinore,
- Garantimi që treguesit për vlerësimin mbulojnë efektet si te gratë, ashtu edhe te burrat,
- Paraqitja e vlerësimit dhe diskutimi i gjetjeve me aktorët e tjerë,
- Nisja e një cikli të ri të politikave mbështetur në gjithë këtë!

Referencat

Abt, Thomas and Winship, Christopher. 2016. *What Works in Reducing Community Violence: A Meta-Review and Field Study for the Northern Triangle*. Washington, DC: United States Agency for International Development.

<https://www.usaid.gov/sites/default/files/USAID-2016-What-Works-in-Reducing-Community-Violence-Final-Report.pdf>

Bevan, James and Nicholas Florian. 2006. 'Few options but the gun: Angry young men'. In *Small Arms Survey 2006: Unfinished Business*. Geneva: Small Arms Survey. <http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/A-Yearbook/2006/en/Small-Arms-Survey-2006-Chapter-12-EN.pdf>

JämStöd. 2007. *Gender Mainstreaming Manual. A Book of Practical Methods from the Swedish Gender Mainstreaming Support Committee*. Stockholm: Swedish Government Official Reports. http://www.includegender.org/wp-content/uploads/2014/02/gender_mainstreaming_manual.pdf

SAS (Small Arms Survey). 2014. *Women and Gun Ownership*. Geneva: Small Arms Survey. http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/H-Research_Notes/SAS-Research-Note-45.pdf

Schroeder, Emily, Vanessa Farr and Albrecht Schnabel. 2005. *Gender Awareness in Research on Small Arms and Light Weapons*:

SEESAC. 2006a. *The Rifle has the Devil Inside – Gun Culture in South Eastern Europe*. Belgrade: SEESAC.

<http://www.seesac.org/f/tmp/files/publication/386.pdf>

UNDP (United Nations Development Programme). 2008. *How to Guide. Small Arms and Light Weapons Legislation*. Geneva: Bureau for Crisis Prevention & Recovery, UNDP.

http://www.poa-iss.org/CASAUplod/Members/Documents/9@SALWGuide_Legislation.pdf

UNPD. 2008a. *How to Guide. The Establishment and Functioning of National Small Arms and Light Weapons Commissions*. Geneva: Bureau for Crisis Prevention & Recovery, UNDP.

<http://www.poa-iss.org/CASAUplod/Members/Documents/9@UNDP%20SALW%20Commissions.pdf>

CIP - Каталогизација у публикацији
Библиотека Матице српске, Нови Сад

623.44:34:[305-055.2(4-12)(036)

BOŽANIĆ, Dragan

Instrument praktik për integrimin e perspektivës gjinore në kuadrin ligjor dhe të politikave për armët e vogla dhe të lehta (SALW)-et / [Dragan Božanić]. - Belgrade : Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, 2016 (Belgrade : Grafolik). - 26 str. : graf. prikazi ; 30 cm

Tiraž 100. - Bibliografija.

ISBN 978-86-7728-244-8

a) Ватрено оружје - Законодавство - Родна перспектива - Југоисточна Европа - Водичи

COBISS.SR-ID 310161671

